



**UNIVERSITETI I PRIZRENIT**  
UNIVERSITY OF PRIZREN

**„Ukshin Hoti“  
Rektorati**

---

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

---

Nr. i ref.

Prizren, më 15. 04. 2015

---

Mbështetur në Udhëzimin Administrativ të MASHT-it nr. 24/2012 e në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues të UPZ-së, të datës 15.04. 2015, Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”shpall:

## **K O N K U R S**

### **Për lirim nga pagesa e semestrit për studentët e Universitetit të Prizrenit për vitin akademik 2014/2015**

Të drejt lirimi nga pagesa e semestrit për vitin akademik 2014/2015 në UPZ kanë:

1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale;
2. Studentët, të cilët janë invalidë të luftës (qofshin ata ushtarakë apo civilë);
3. Studentët, që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës (gjatë periudhës 01.01.1998 -12.06.1999) dhe fëmijët e Invalidëve të UÇK-së;
4. Studentët me aftësi të kufizuara fizike;
5. Studentët e të njëjtit prind i cili ka tre (3) e me shumë studentë të rregullt në studime në Universitetet publike të Kosovës.

**Të gjithë studentët duhet t'i paraqesin:**

- Kërkesën për lirim nga pagesa e semestrit dhe
- Vërtetimin e studimeve për vitin akademik 2014 - 2015

**1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale, i paraqesin edhe:**

- a. Kopjen e vërtetuar të vendimit të ndihmës sociale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ;
- b. Vërtetimin e Qendrës për Punë Sociale për familjen dhe studentin ( forma shkarkohet web-faqja ose merret në QPS në Komunë);
- c. Kopjen e letërnjoftimit të bartësit të ndihmës sociale;
- d. Kopjen e letërnjoftimit të studentit/ës;
- e. Certifikatën e lindjes së studentit/ës.

2. **Studentët që janë invalid të luftës (ushtarakë apo civilë) i paraqesin edhe:**
  - a. Kopjen e vërtetuar të vendimit të pensionit për invalid të luftës apo invalid civil të luftës nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose nga komuna përkatëse;
  - b. Kopjen e letërnjoftimit të studentit /ës invalid.
  
3. **Studentët që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës dhe invalidëve të UÇK-së, i paraqesin edhe:**
  - a. Kopjen e vërtetuar të vendimit për njohjen e statusit të familjes së dëshmorit, viktimës civile dhe invalidëve të UÇK-së, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose nga komuna përkatëse;
  - b. Kopjen e letërnjoftimit të bartësit të statusit të familjes së dëshmorit/viktimës civile;
  - c. Kopjen e letërnjoftimit të studentit/ës;
  - d. Certifikatën e lindjes së studentit/ës.
  
4. **Studentët me aftësi të kufizuara fizike i paraqesin edhe:**
  - a. Kopjen e vërtetuar të vendimit për njohjen e statusit person me aftësi të kufizuara fizike nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose nga shoqatat e licencuara të personave me aftësi të kufizuara;
  - b. Kopjen e letërnjoftimit të studentit/ës.
  
5. **Njëri nga tre ose më shumë student e së njëjtës familje të ngushtë që studiojnë në Universitetet publike i paraqesin:**
  - a) Certifikatën e lindjes së studentëve;
  - b) Vërtetimet e të gjithë studentëve për regjistrimin në vitin akademik 2014/2015.

**Dokumentet e kompletuar duhet të dorëzohen në Zyrën nr. 308**

Kërkesat dhe dokumentacioni i pranuar zyrtarisht nga zyra nr. 308 i dorëzohet Komisionit për lirim në Rektoratin e Universitetit të Prizrenit.

Me rastin e paraqitjes për lirim nga pagesa e semestrit, studentët duhet t'i sjellin vetëm dokumentet origjinale.

**Afati për konkurrim është prej datës 07.05.2015 e deri më 21.05.2015**

Format e nevojshme për konkurrim gjenden në web-faqen e Universitetit të Prizren

**www.uni-prizren.com** dhe në Zyrën nr. 308